

Shoqërohet në Polici 29-vjeçari nga Kaçaniku, postoi video me armë



25/08/2023 09:23

f

t

link

Një person është arrestuar nga Policia e Kosovës në Kaçanik, pasi i njëjti kishte postuar në rrjete sociale një video ku shihej duke përdorur një armë.

Në njoftimin e Policisë bëhet e ditur se 29-vjeçari pas intervistimit nga policët hetues është liruar për procedurë të mëtejme hetimore, ndërsa arma është konfiskuar.

“Stacioni i Policisë në Kaçanik ka pranuar një informacion se një person në rrjetin social ‘TikTok’, ditë më parë kishte shpërndarë një video, ku shihej duke e përdorur një armë. Policët hetues të stacionit në Kaçanik i kanë marrë veprimet e menjëhershme dhe nën autorizim të prokurorit kujdestar nga Prokuroria Themelore në Ferizaj i kanë nisur hetimet, ndërsa kanë arritur që me datën 24.08.2023 rreth orës 23:00 të identifikojnë personin e dyshuar F.M (M/K) i moshës 29 vjeçar, i cili është shoqëruar në stacionin e policisë në Kaçanik dhe pas intervistimit nga policët hetues, me vendim të prokurorit është liruar për procedurë të rregullt të mëtejme hetimore, ndërsa arma (pistoletë) është konfiskuar”, thuhet në njoftim.

Rasti është cilësuar “Mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim i pa autorizuar i armëve – përdorimi armës”.

Artikuj të ngjashëm



August 25, 2023

Maqedonci del për herë të parë në konferencë si ministër: Fokusi...



August 25, 2023

Qeveria përfundon edhe njëherë në Kushtetuese



August 25, 2023

“Oj nanë bre” – Po krekosej me shpejtësinë e veturës, i...



August 25, 2023

Vdes një grua në QKUK, po trajtohej tash e sa ditë aty



August 25, 2023

Hapet linku për aplikim për subvencionim të librave shkollor



August 25, 2023

Grabitje e armatosur në një pompë të derivateve në Lipjan

LAJME TË FUNDIT

-
- Maqedonci del për herë të parë në konferencë...
-
- “Sa turp, BATE tashmë ka vdekur” – tifozët...
-
- “Oj nanë bre” – Po krekosej me shpejtësinë...
-
- Kroos bën parashikim interesant: Xhaka do të marrë...

Other Links

- Fact-Checking Policy
- Ethics Policy
- Corrections Policy
- Ownership & Funding Information
- Editorial Team Information